



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1037/2 Prot.

Tepelenë, më 03.06.2026

V E N D I M

Nr. 42, datë 28.05.2026

“PËR MIRATIMIN E DHËNIES, NDIHMË FINANCIARE PERSONAVE PËR DËMIN E SHKAKTUAR NGA FATKEQËSIT NATYRORE, ZJARRI”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54 dhe nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, kreut III, pika 1, shkronjës “e”, të vendimit nr. 329, datë 16.05.2012, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, “Këshilli Bashkisë, pas shqyrtimit të relacionit të Komisionit të Emergjencave në bashki, proces-verbalit të konstatimit të gjëndjes dhe dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve, merr vendimin për dhënien e ndihmës financiare, në të cilin përmendet dhe masa e ndihmës së dhënë nga ky organ”,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhënien e mbështetjes financiare për 20 (njëzetë) shtetas të dëmtuar nga zjarret në territorin e Bashkisë Tepelenë.
2. Të akordojë ndihmë financiare për shtetasit e dëmtuar, sipas vlerësimit të dëmeve dhe dokumentacionit përkatës, bazuar në tabelat bashkëlidhur këtij projektvendimi, si më poshtë:
 - a) Tabela përmbledhëse e dëmeve të shkaktuara nga zjarret, në vlerën totale 2 825 000 (dy milionë e tetëqind e njëzetë e pesë mijë) lekë, e detajuar sipas vlerës për çdo të dëmtuar;
3. Ndihma financiare do të përballohet nga fondi rezervë i Bashkisë Tepelenë dhe fondi për emergjencat civile, miratuar për vitin 2026.
4. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Tepelenë, i cili është pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miraturar me 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur më datë 03.06.2026

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI



a. TABELA NE VLERË LEKU E DËMEVE NGA ZJARRET

Nr	Emer Mbiemer	Njesia	sasia	Mosha	çmimi lekë/njesi	Vlera në lekë
1	Aleks Shumeli	rrënjë,ullinj	50	20 vjeçar	4000	200000
2	Enea Mici	koshere blete	15		15000	225000
3	Hilmi Bushaj	rrënjë,ullinj	30	4 vjeçar	1000	30000
4	Kozma Shumeli	rrënjë,ullinj	50	22 vjeçar	4000	200000
5	Erjon Toti	rrënjë,ullinj	30	20 vjeçar	4000	120000
6	Oltjon Gjokthomi	rrënjë,ullinj	130	2 vjeçar	1000	130000
7	Robert Dina	rrënjë,ullinj	12	18 vjeçar	4000	48000
8	Alvaro Poleri	rrënjë,ullinj	20	15 vjeçar	4000	80000
9	Justin Puleri	rrënjë,ullinj	20	5 vjeçar	1000	20000
10	Sokrat Kasneci	rrënjë,ullinj	20	20 vjeçar	4000	80000
11	Agim Zifla	rrënjë,ullinj	70	25 vjeçar	4000	280000
12	Halit Dina	rrënjë,ullinj	40	15 vjeçar	4000	160000
13	Mine Beja	rrënjë,ullinj	60	25 vjeçar	4000	240000
14	Dritan Dhromi	rrënjë,ullinj	10	12 vjeçar	4000	40000
15	Besmir Kokona	rrënjë,ullinj	70	15 vjeçar	4000	280000
16	Kujtim Kokona	peme frutore ,shegë	20		200	4000
	Kujtim Kokona	dardhe,kumbul la,pjeshkë	66		500	33000
	Kujtim Kokona	arra	10	15 vjecar	6000	60000
17	Evirjon Kuca	,kumb,dardhe	40	3-vjecare	500	20000
18	Jaho Shehu	rrënjë,ullinj	35	mbi 25 vjeçar	6000	210000
19	Kleart Vjoleta Shehu	rrënjë,ullinj	40	mbi 25 vjeçar	6000	240000
20	Myzafer Liçi	koshere blete	5		25000	125000
	totali ne leke					2825000

Eksperti Privat
Myzafer Liçi

